



## SUCCESS STORY

### Dalja nga errësira: Ndrëçimi rrugor bën fshatin kosovar më të sigurtë

#### Dritat e ndritshme me çmim të përballueshëm lehtësojnë udhëtimin natën



[Photo by Advancing Kosovo Together]

Banorët më të rinj të Kufcës së Epërme (Novobërdë) mund të ecin nëpër rrugë të sigurtë, nën ndriçimin e ri rrugor LED i cili shfrytëzon energjinë me efikasitet.

“Asnjëri (përfaqësuesit e dy etnive) nuk ushtroi presion mbi tjetrin. Që të dy ishin të interesuar për sigurinë e fshatit.”

Shtator 2015 – Banorët e Kufcës së Epërme, fshatit më të madh në Komunën e Novobërdës, tani mund të shohin nëpër errësirë. Me instalimin e ndriçimit të ri rrugor me dioda ndriçuese LED – projekt ky i përbashkët i USAID-it dhe komunës – 2000 banorët e fshatit tani mund të udhëtojnë natën shumë më të sigurtë.

Fshati është i banuar me shumicë serbe, por gjithashtu ka edhe një pakicë të madhe shqiptare. Në dhjetor të vitit 2014, gjatë një takimi të forumit multi-etnik të komuniteteve, banorët shprehën si prioritarë nevojën për një ndriçim publik i cili do t'i bënte rrugët e tyre më të sigurta. Takimi u organizua nga programi i USAID-it Avancojmë Kosovën së Bashku (AKT).

Predrag Gjorgjeviqi, lider i fshatit dhe deputet i asamblesë komunale, e përshkroi projektin si “me interes për të dy komunitetet. Asnjëri nuk ushtroi presion mbi tjetrin. Që të dy ishin të interesuar për sigurinë e fshatit.”

Nebojsa Arsiqi, drejtor i departamentit komunal të shërbimeve publike, shtoi: “Ne po ballafaqohemi me shumë sfida; për shembull, disa nga fshatrat nuk kanë as sistem të ujsjellësit e as të kanalizimit të ujërave të zeza, ndërsa buxheti ynë është i pamjaftueshëm për t'i trajtuar të gjitha këto probleme, prandaj mbështetja e USAID-it ka rëndësi të madhe për ne.

Ndriçimi ekologjikisht i favorshëm u instalua brenda 20 ditësh, me një çmim të arsyeshëm. Falë faktit që dritat LED janë shumë të ndritshme, mjaftoi vendosja e vetëm nga një drite në çdo të dytën shtyllë elektrike. Komuna pagoi 20 përqind të shpenzimeve të instalimit dhe tani paguan faturë elektrike pak më të lartë e cila, në shumën prej 200 euro në muaj për tërë fshatin, është më se e lirë.

Si qendra e mjekësisë ashtu edhe shkolla, që të dyjat gjenden brenda shtatë kilometrave të mbuluara me ndriçimin e ri. Meqë shkolla punon në tri ndërrime, paraprakisht, më shumë se 140 nxënësit që vijojnë shkollën e mesme të fshatit ishin të mërzhitur dhe të frikësuar nga ecja nëpër rrugë të errëta, pa ndriçim. Tani, nxënësit e ndërrimit të fundit mund të shohin kur ecin rrugës për në shtëpi edhe pasi të bie terri.

Fshatrat tjera përrreth po e shqyrtojnë mundësinë e zbatimit të projekteve të ngjashme për t'i ndriçuar rrugët e veta.

Programi trevjeçar Avancojmë Kosovën së Bashku (AKT) ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe ndërveprimit konstruktiv ndëretnik, i cili është i rëndësishëm thelbësor për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit. Ky program, i cili ka filluar në gusht të vitit 2014, ka një qasje holistike ndaj integritetit të popullatave minoritare në institucionet dhe shoqërinë e Kosovës, duke punuar me komuna dhe partnerë tjerë qeveritar.